

VENDIM
Nr. 200, datë 13.3.2013

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT PËR SHËRBIMIN E MARKIMIT DHE
MONITORIMIT TË KARBURANTEVE TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË
FINANCave TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË
SHOQËRIVE “GLOBAL FLUIDS INTERNATIONAL” S.A. DHE “PETROLEUM
CONSULTING PARTNERS” A.G.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, e 27 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G., sipas tekstit dhe shtojcave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha